

FJALA E DEPUTETES ORJOLA PAMPURI

E HËNË 31 TETOR 2022

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

E nderuar zonja kryesuese e seancës,

Të nderuara zonja bashkëkryetare të komisionit,

Të nderuar zotërinj, anëtarë të Komisionit të Reformës Territoriale që keni bërë një punë shumë të mirë gjatë kësaj kohe dhe keni sjellë një raport shumë të mirë, sigurisht, edhe me mbështetjen e dy ekspertëve që bënë një punë shteruese,

Unë nuk do ta nis fjalën time pa u ndalur në atë që zoti Balla tha se tani njerëzit paskan mundësi të shkojnë me autobus për të marrë një certifikatë, për të shkuar në qendrën shëndetësore ose për të shkuar në shkollë!

Për sa i përket raportit, ai është shterues, i qartë dhe i mirë, por le të zbresim në terren. Si përfaqësuese e qarkut të Tiranës, e zonave për të cilat kemi propozuar ndarjen për bashkitë e reja në Tiranë, një banor më telefoni dhe më tha se do të vijë në Tiranë të marrë një dokument, por e parashikon në agjendën e tij një herë në muaj për të zbritur në Tiranë, sepse banon në Vrap të Tiranës dhe nuk ka rrugë. Po si mund të flasësh për qendër shëndetësore, kur infermierja duhet të shkojë më helikopter, se nuk ka asnjë lloj mundësie për të shkuar atje? Si mund të flasësh në këto kushte për shkollë dhe për stafin arsimor që duhet të shkojë të punojë atje?

Kalojmë në anën tjetër, në zonën e Zall-Bastarit ku vetëm një qendër është bërë nga bashkia, pjesa tjetër, Bastari i Mesëm dhe të gjitha fshatrat me radhë, zonat me radhë janë të pabanueshme. Kjo ka nxitur shpopullimin dhe shumë banorë të zonave të mira ku ka prodhimtari shumë të lartë, janë zhvendosur në Tiranë ose kanë emigruar. Ky është shpopullimi, pra ose vijnë në Tiranë dhe rrisin numrin e familjeve të varfra, ose ikin nga Shqipëria. Ndaj dhe ky raport që ne kemi prezantuar, për të cilin kanë punuar ekspertët, është një raport për të cilin ne jemi konsultuar, kemi folur kemi takuar grupe të ndryshme interesi për një vit rresht dhe kemi dalë në atë rezultat. Por faji nuk është i asnjërit prej nesh

këtu, faji është se këtu një vendim kaq i rëndësishëm, që është për nevoja kaq jetike për qytetarët në terren, duhet të merret me referendum, ku ky raport i joni duhet të votohet masivisht, sepse në takimet që ne kemi pasur, nuk kanë qenë as punonjës bashkie, as punonjës administrate, por qytetarët e thjeshtë që duan të marrin shërbime çdo ditë, por u mungojnë, ose u marrin më shumë kohë dhe kanë më shumë kosto.

Riorganizimi i bashkive dhe krijimi i bashkive të reja rurale do të krijojë kushte për zhvillimin ekonomik lokal, rural, agroturizmin dhe rigjallërimin e jetës sociale, ekonomike dhe politike me pritshmëri për të frenuar shpopullimin. Gjithashtu, do të ndikojë në reduktimin e pabarazive midis zonave rurale dhe urbane, si edhe në krijimin e kushteve të domosdoshme për zhvillimin e qëndrueshëm dhe kontrollin e territorit.

A u përmbushën premtimet dhe a e realizoi ndikimin e saj reforma që riorganizoi nivelin e parë të pushtetit vendor në 61 bashki? Absolutisht jo. Nga takimet që kemi pasur, kemi parë që nuk e ka realizuar. Në çdo rrugë të zonave rurale që kemi shkelur, për të gjitha rrugët e asfaltuara na thanë se ishin bërë kur ishin ish-kryetarët e bashkive, ndërkohë tani kryetarët e njësive bashkiake janë bosët e zonave, të cilët në kohën e zgjedhjeve menaxhojnë votat. Besoj të gjithë kemi qenë prezentë kur kryetarët e njësive bashkiake rrinin me listë dhe shikonin sa kanë votuar dhe ishin të sigurt edhe sa do të vinin të votonin dhe sa vota kishte për PS-në në kuti. Këta janë kryetarët e njësive bashkiake dhe ky është suksesi i reformës territoriale me 61 bashki.

Shumica e bashkive vazhdojnë të vuajnë nga sistemet e qeverisjes jo të kënaqshme dhe shpesh jofunksionale, duke përfshirë shpërndarjen e papërshtatshme të burimeve, sistemet joefikase të të ardhurave dhe ofrimin e dobët të shërbimeve jetike publike. Një qeverisje e tillë e dobët çon në rezultate të padëshiruara për aksesin në shërbimet publike nga të varfrit dhe të pafavorizuarit e shoqërisë. Nevoja për të mbuluar dhe për t'i administruar në mënyrë efektive territoret e largëta nga qendrat mbetet koherente, gjithashtu, transporti publik, strehimi, mirëmbajtja e rrugëve rurale.

Tri janë shkallët që zonja Çupi shumë qartë i theksoi: decentralizimi administrativ, decentralizimi politik dhe decentralizimi financiar. Me këtë ndarje të re territoriale, që propozojmë, bashkitë e reja do të kenë pushtet administrativ, duke kryer një sërë detyrash, sidomos për sa i përket zhvillimit ekonomik në zonat rurale apo edhe aspekte të tjera rregullatore, që lidhen me bujqësinë, pyjet, kullotat, vaditjen, sektorin e agrobiznesit, turizmin rural, rrugë rurale. Decentralizimi politik është ai që unë përmenda, por duhet të ketë më shumë vendimmarrje dhe vendimmarrës për qytetarët, më shumë të zgjedhur, më shumë

këshilla bashkiakë, më shumë alternativa. Këta kryetarë të njësive bashkiake do të jenë të zgjedhur nga qytetarët dhe jo të emëruar nga kryetari i bashkisë, pra jo skllëvër të tij.

Për sa i përket decentralizimit financiar, bashkitë do të jenë të lira të shpenzojnë të ardhurat nga burimet e tyre si dhe do të operojnë lirshëm me transfertat e pakushtëzuara. Këto që përmenda më sipër janë të rëndësishme, por do të thosha që ndarja e tri bashkive të reja: Bashkia e Farkës që përfshin Petrelën, Baldushkun Bërzhitën, Dushkun, Kërrabën; Bashkia e Kasharit që përfshin Ndroqin, Pezën dhe Dajtin; Bashkia e Dajtit që përfshin Dajtin, Shëngjergjin, Zall- Bastarim dhe Zall-Herr, duke iu shtuar kështu bashkive, Tiranë, Kamzë, Vorë, Kavajë dhe Rogozhinë, do të shërbejë për më shumë shërbime, në cilësi dhe kohë, kosto efektive dhe kushte më të mira për këdo që jeton apo do të rikthehet në shtëpitë e braktisura për t'i përftuar këto shërbime të munguara. Faleminderit!